**VENDIM**
**Nr. 342, datë 4.5.2016**

# PËR MIRATIMIN E KUFIJVE TERRITORIALË E HIDROGRAFIKË TË BASENEVE UJORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE QENDRËN E PËRBËRJEN E KËSHILLIT TË SECILIT PREJ TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave "a" e "b", të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Territori i Republikës së Shqipërisë, në funksion të administrimit të burimeve ujore, ndahet në gjashtë basene ujore, me qendrat përkatëse, si më poshtë vijon:

a) Baseni ujor Drin–Bunë, me qendër në Shkodër;

b) Baseni ujor Mat, me qendër në Lezhë;

c) Baseni ujor Ishëm–Erzen, me qendër në Tiranë;

ç) Baseni ujor Shkumbin, me qendër në Elbasan;

d) Baseni ujor Seman, me qendër në Fier;

dh) Baseni ujor Vjosë, me qendër në Vlorë.

2. Përcaktimi i kufijve territorialë të çdo baseni është sipas hartës administrative, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Përcaktimi i kufijve hidrografikë të çdo baseni është sipas hartave respektive të çdo baseni ujor, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Administrimi i integruar i burimeve ujore në Republikën e Shqipërisë, në nivel baseni ujor, të kryhet mbi bazën e kufijve të rinj territorialë, të përcaktuar nga analiza e kufijve hidrografikë, sipas hartave bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Për çdo basen ujor funksionon Agjencia e Basenit Ujor (ABU), në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të burimeve ujore.

6. Për çdo basen ujor funksionon Këshilli i Basenit Ujor (KBU), në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi për administrimin e burimeve ujore.

7. Numri i anëtarëve për këshillat e basenit ujor të jetë, si më poshtë vijon:

| | |
|---|---|
| a) Baseni ujor Drin–Bunë | 23 anëtarë; |
| b Baseni ujor Mat | 15 anëtarë; |
| c) Baseni ujor Ishëm–Erzen | 21 anëtarë; |
| ç) Baseni ujor Shkumbin | 17 anëtarë; |
| d) Baseni ujor Seman | 29 anëtarë; |
| dh) Baseni ujor Vjosë | 27 anëtarë. |

8. Kryetari i KBU-së të jetë prefekti i prefekturës më të madhe të qarkut në të cilin ndodhet basenin ujor, i cili do të jetë në këtë funksion për aq kohë sa ushtron detyrën si prefekt.

9. Nënkryetari i KBU-së të zgjidhet nga Këshilli i Basenit Ujor.

10. Sekretari i KBU-së të jetë drejtuesi i Agjencisë së Basenit Ujor, i emëruar nga ministri përgjegjës për menaxhimin e burimeve ujore.

11. Përbërja e anëtarëve të këshillave të gjashtë baseneve ujore të jetë, si më poshtë vijon:

11.1 Këshilli i Basenit ujor Drin–Bunë:

11.1.1 Prefekti i Shkodrës - kryetar.

11.1.2 Drejtues të nivelit të lartë të bashkive, të emëruar nga kryetarët përkatës:

| | |
|---|---|
| i) Malësi e Madhe | 1 anëtar; |

ii) Tropojë 1 anëtar;
iii) Shkodër 1 anëtar;
iv) Fushë-Arrës 1 anëtar;
v) Has 1 anëtar;
vi) Vau i Dejës 1 anëtar;
vii) Pukë 1 anëtar;
viii) Kukës 1 anëtar;
ix) Dibër 1 anëtar;
x) Lezhë 1 anëtar;
xi) Bulqizë 1 anëtar;
xii) Librazhd 1 anëtar;
xiii) Pogradec 1 anëtar.

11.1.3 Drejtues të institucioneve lokale:

i) Agjencia rajonale e mjedisit (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

ii) Drejtoria e zonave të zonave të mbrojtura (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

iii) Drejtoritë rajonale të shëndetit publik (2 anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.1.4 Grupet e interesit për:

i) mbrojtjen e burimeve ujore (1 anëtar i shoqatave mjedisore, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

ii) furnizimin me ujë (1 anëtar i shoqatave, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

iii) ujitjen (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

iv) hidroenergji dhe industri (2 anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.2 Këshilli i Basenit ujor Mat:

11.2.1 Prefekti i Lezhës - kryetar.

11.2.2 Drejtues të nivelit të lartë të bashkive, të emëruar nga kryetarët përkatës:

i) Mirditë 1 anëtar;
ii) Kurbin 1 anëtar;
iii) Mat 1 anëtar;
iv) Klos 1 anëtar;
v) Fushë-Arrës 1 anëtar;
vi) Pukë 1 anëtar;
vii) Lezhë 1 anëtar;
viii) Bulqizë 1 anëtar.

11.2.3 Drejtues të institucioneve lokale:

i) Agjencia rajonale e mjedisit (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

ii) Drejtoritë rajonale të shëndetit publik (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.2.4 Grupet e interesit për:

i) mbrojtjen e burimeve ujore (1 anëtar i shoqatave mjedisore, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

i) furnizimin me ujë (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

iii) ujitjen (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

iv) hidroenergji dhe industri (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.3 Këshilli i Basenit ujor Ishëm–Erzen:

11.3.1 Prefekti i Tiranës - kryetar.

11.3.2 Drejtues të nivelit të lartë në bashki, të emëruar nga kryetarët përkatës:

i) Krujë 1 anëtar;
ii) Durrës 1 anëtar;
iii) Vorë 1 anëtar;
iv) Tiranë 1 anëtar;
v) Shijak 1 anëtar;
vi) Kamzë 1 anëtar;

vii) Kurbin 1 anëtar.

11.3.3 Drejtues të institucioneve lokale:

i) Agjencia rajonale e mjedisit (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

ii) Drejtoria e zonave të mbrojtura (1 anëtar, 1 miratuar nga kryetari i KBU-së);

iii) Drejtoritë rajonale të shëndetit publik (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

iv) Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.3.4 Grupe interesi për:

i) mbrojtjen e burimeve ujore (2 anëtarë të shoqatave mjedisore, të miratuar nga kryetari i KBU-së);

ii) furnizimin me ujë (2 anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së);

iii) ujitjen (2 anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së);

iv) hidroenergji dhe industri (3 anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.4 Këshilli i Basenit ujor Shkumbin:

11.4.1 Prefekti i Elbasanit - kryetar.

11.4.2 Drejtues të nivelit të lartë të bashkive, të emëruar nga kryetarët përkatës:

| | |
|---|---|
| i) Librazhd | 1 anëtar; |
| ii) Elbasan | 1 anëtar; |
| iii) Rrogozhinë | 1 anëtar; |
| iv) Kavajë | 1 anëtar; |
| v) Peqin | 1 anëtar; |
| vi) Pogradec | 1 anëtar; |
| vii) Përrenjas | 1 anëtar; |
| viii) Divjakë | 1 anëtar. |

11.4.3 Drejtues të institucioneve lokale:

i) Agjencia rajonale e mjedisit (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

ii) Administrata e zonave të mbrojtura (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

iii) Drejtoritë rajonale të shëndetit publik (2 anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.4.4 Grupe interesi për:

i) mbrojtjen e burimeve ujore (1 anëtar i shoqatave mjedisore, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

ii) furnizimin me ujë (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

iii) ujitjen (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);

iv) hidroenergjinë dhe industrinë (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.5 Këshilli i Basenit ujor Seman:

11.5.1 Prefekti i Fierit - kryetar.

11.5.2 Drejtues të nivelit të lartë të bashkive, të emëruar nga kryetarët përkatës:

| | |
|---|---|
| i) Divjakë | 1 anëtar; |
| ii) Lushnjë | 1 anëtar; |
| iii) Belsh | 1 anëtar; |
| iv) Cërrik | 1 anëtar; |
| v) Gramsh | 1 anëtar; |
| vi) Kuçovë | 1 anëtar; |
| vii) Ura-Vajgurore | 1 anëtar; |
| viii) Roskovec | 1 anëtar; |
| ix) Patos | 1 anëtar; |
| x) Fier | 1 anëtar; |
| xi) Pustec | 1 anëtar; |
| xii) Maliq | 1 anëtar; |
| xiii) Berat | 1 anëtar; |
| xiv) Korçë | 1 anëtar; |
| xv) Devoll | 1 anëtar; |

| | |
|---|---|
| xvi) Skrapar | 1 anëtar; |
| xvii) Poliçan | 1 anëtar; |
| xviii) Kolonjë | 1 anëtar; |
| xix) Elbasan | 1 anëtar; |
| xx) Mallakastër | 1 anëtar. |

11.5.3 Drejtues të institucioneve lokale:

i) Agjencia rajonale e mjedisit (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
ii) Administrata e zonave të mbrojtura (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
iii) Drejtoritë rajonale të shëndetit publik (2 anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.5.4 Grupe interesi për:

i) mbrojtjen e burimeve ujore (1 anëtar i shoqatave mjedisore, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
ii) furnizimin me ujë (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
iii) ujitjen (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
iv) hidroenergji dhe industri (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.6 Këshilli i Basenit ujor Vjosë:

11.6.1 Prefekti i Vlorës - kryetar.

11.6.2 Drejtues të nivelit të lartë të bashkive, të emëruar nga kryetarët përkatës:

| | |
|---|---|
| i) Mallakastër | 1 anëtar; |
| ii) Përmet | 1 anëtar; |
| iii) Këlcyrë | 1 anëtar; |
| iv) Memaliaj | 1 anëtar; |
| v) Selenicë | 1 anëtar; |
| vi) Vlorë | 1 anëtar; |
| vii) Himarë | 1 anëtar; |
| viii) Sarandë | 1 anëtar; |
| ix) Gjirokastër | 1 anëtar; |
| x) Tepelenë | 1 anëtar; |
| xi) Libohovë | 1 anëtar; |
| xii) Dropull | 1 anëtar; |
| xiii) Finiq | 1 anëtar; |
| xiv) Delvinë | 1 anëtar; |
| xv) Konispol | 1 anëtar; |
| xvi) Fier | 1 anëtar; |
| xvii) Kolonjë | 1 anëtar. |

11.6.3 Drejtues të institucioneve lokale:

i) Agjencia rajonale e mjedisit (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
ii) Administrata e zonave të mbrojtura (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
iii) Drejtoritë rajonale të shëndetit publik (2 anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së).

11.6.4 Grupe interesi për:

i) mbrojtjen e burimeve ujore (1 anëtar i shoqatave mjedisore, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
ii) furnizimin me ujë (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
iii) ujitjen (1 anëtar, i miratuar nga kryetari i KBU-së);
iv) hidroenergjinë dhe industrinë (2 anëtarë, të miratuar nga kryetari i KBU-së).

12. Ngarkohen organet kombëtare të admini-strimit dhe menaxhimit të burimeve ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**




# Harta ADMINISTRATIVE

## Legjenda

- Qytetet
- Bashkite
- Hidrografia

**Basenet**

- Drini
- Ishem-Erzen
- Mat
- Semani
- Shkumbini
- Vjosa

| | |
|---|---|
| Projeksioni | : ETRS 1989 |
| Burimi i te dhenave | :Ministria e Shtetit per Ceshtjet Vendore |
| Punuar ne shkallen | : 1: 200 000 |

MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

**Pergatitur:**

Ministria e Bujqesise, Zhvillimit Rural dhe Administrimit te Ujerave



MALI I ZI
KOSOVA
N
BASENI DRIN - BUNA
MAT
DETI ADRIATIK
MAQEDONIA
40 20 0 40 Kilometers
BASENI DRIN - BUNA
Legjenda
Projeksioni : ETRS 1989
Burimi i te dhenave : AKM
Punuar ne shkallen : 1: 150 000
MINISTRIA E BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Pergatitur:
Ministria e Bujqesise,
Zhvillimit Rural dhe
Administrimit te Ujerave


BASENI I MATIT
Legjenda
Baseni MATIT
Hidrografia
Qytetet
Projeksioni : ETRS 1989
Burimi i te dhenave : AKM
Punuar ne shkallen : 1: 100 000
Pergatitur:
Ministria e Bujqesise,
Zhvillimit Rural dhe
Administrimit te Ujerave
N
20
42
41
DRINI
DETI ADRIATIK
ISHEM-ERZEN
SHKUMBINI
BASENI I MATIT
FUSHE-ARREZI
REPSI
KURBNESHI
RUBIK
RRESHENI
MILOTI
LACI
BURRELI
KLOSI
25
12.5
0
25 Kilometers


BASENI ISHEM - ERZENI
Legjenda
Projeksioni : ETRS 1989
Burimi i te dhenave : AKM
Punuar ne shkallen : 1: 100 000
Pergatitur:
Ministria e Bujqesise, Zhvillimit Rural dhe Administrimit te Ujerave
MAT
SHKUMBINI
DETI ADRIATIK
BASENI ISHEM - ERZENI
KRUJA
FUSHE-KRUJA
MANZA
VORA
KAMZA
SUKTHI
SHIJAKU
DURRESI
TIRANA
N
25
12.5
0
25 Kilometers
20


BASENI I SHKUMBINIT
Legjenda
Pergatitur:
Ministria e Bujqesise, Zhvillimit Rural dhe Administrimit te Ujerave
MAT
DRINI
ISHEM - ERZENI
DETI ADRIATIK
BASENI I SHKUMBINIT
LIBRAZHDI
ELBASANI
RROGOZHINA
PEQINI
CERRIKU
DIVJAKA
PRRENJASI
SEMANI
N
25
12.5
0
25 Kilometers
20


BASENI I SEMANIT
SHKUMBINI
DRINI
DETI ADRIATIK
BASENI I SEMANIT
VJOSA
Legjenda
Pergatitur:
Ministria e Bujqesise,
Zhvillimit Rural dhe
Administrimit te Ujerave


BASENI VJOSA
SEMANI
BASENI VJOSA
DETI JON
GREQI
Legjenda
Pergatitur:
Ministria e Bujqesise,
Zhvillimit Rural dhe
Administrimit te Ujerave